


**2019-2021**



*ООУ „ ЕДИНСТВО „  
SHFK „ BASHKIMI „  
BIO „ BIRLIK „*

**VETËEVAULIMI**

## Letërnjoftimi i shkollës

## Të dhëna të përgjithshme për shkollën

<b>Emri i shkollës</b>	Bashkimi –Edinstvo- Birluk
<b>Adresa ,komuna, vendi</b>	Rruga.Pançe Popovski nr.35, Gostivar
<b>Kontakt informacionet e-mail</b>	bashkimi-edinstvo@live.com
<b>Numri i shkollave periferike</b>	3
<b>Lokacionet e shkollave periferike</b>	F.sh. Bellovisht, F.sh. Llakavicë dhe Lagja.Tullana
<b>Numri i nxënësve</b>	1371
<b>E formuar prej</b>	29.06.1962
<b>E verifikuar – numri i aktit</b>	10-1465/13 од 10.06.1996
<b>Mësimi zhvillohet në këto gjuhë:</b>	Maqedonase, shqipe dhe turke
<b>Hapësira e objektit</b>	1320 m <sup>2</sup>
<b>Hapësira e tereneve sportive</b>	590,96 m <sup>2</sup>

Në bazë të ligjit për arsim fillor ( Gazeta zyrtare e R.M.V. 103/2008 ) neni 146 dhe 147 dhe Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për shkollim fillor ( Gazeta zyrtare R.M.V. 33/2010 ) neni 17 dhe 18 për sigurim të kualitetit në mësim këshilli i shkollës në çdo katër vjet sjell program për zhvillimin e shkollës në të cilën merren parasysh rezultatet nga vetëevaulimi, I cili realizohet nga ana e komisionit shkollor, ndihma profesionale këshillëdhënëse nga B.ZH.A. , rekomandimet nga raporti I evaulimit integral që u krye nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit si dhe nga rezultatet e evaulimit ekstern të ngërthyera në raportin vjetor të punës së arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional nga ana e Qendrës Shtetërore për Provime.Shkolla në çdo dy vjet bënë vetëevaulimin. Vetëevaulimi kryhet në fund të çdo dy viteve mësimore.

Në pajtim me dispozitat të nenit 147 paragrafi 3 të Ligjit për arsim fillor, Këshilli i shkollës i SH.F.K. “Bashkimi”-Gostivar solli

### Vendim

#### **Për formimin e komisionit për vetëevaulim të shkollës me nr.02-67/3 prej 24.02.2019**

Me propozim të drejtorit u formua komision për vetëevaulim në përbërje:

- |    |                                      |                      |
|----|--------------------------------------|----------------------|
| 1. | Kalina Gjorgjioska /Lulzime Beqiri   | → Psikolog / Pedagog |
| 2. | Vjollca Ademi                        | → arsimtar lëndor    |
| 3. | Jovanka Nikolloska                   | → arsimtar lëndor    |
| 4. | Bukurie Selimi                       | → arsimtar klasor    |
| 5. | Elizabeta Grujoska / Rezarta Ibraimi | → prindër            |

Në bazë të nenit 147 të Ligjit për arsim fillor komisioni për vetëevaulim e solli këtë

## **Raport**

për vetëevaulim të SH.F.K. “Bashkimi”-Gostivar

### **Arsyetim:**

Komisioni në përbërje: Lulzime Beqiri, Kalina Gjorgjioska, Vjollca Ademi, Jovanka Nikollovska, Bukurie Selimi, Elizabeta Georgievaska dhe Rezearta Ibraimi (prindër) e formuar nga ana e Drejtorit me vendim nr.02-46/2 më date 24.04.2019 e solli raportin për këto fusha:

- Planet dhe programet mësimore
- Të arriturat e nxënësve
- Të mësuarit dhe mësimi
- Përkrahja e nxënësve
- Klima shkollore dhe mardhëniet në shkillë
- Resurset
- Drejtimi, udhëheqja dhe krijimi i politikave

Komisioni i shqyrtoi raportet e timit për vetëevaulim dhe përmirësimin e kualitetit të shkollës me çka I konstatoi anët e forta, anët e dobta, kanosjet dhe mendimet e shkollës dhe propozim masat për largimet e lëshimeve dhe përmirësimin e punës së shkollës.

**Timi për përmirësimin e kualitetit të punës dhe vetëvlerësimin e shkollës sipas fushave**

Me qëllim që të përmirësohet kualiteti i punës dhe vetëvlerësimi i shkollës është bërë ekipimi i timit e përbërë nga shtatë fusha

<b>1.Planet dhe programet mësimore</b>  ❖ Grupa punuese  ➤ Vjollca Ademi ➤ Sillvana Rusu ➤ Lejla Hamzi	<b>2.Të arriturat e nxënësve</b>  ❖ Grupa Punuese  ➤ Jovanka Nikolloska ➤ Merita Nuredini ➤ Senaj Sarixhe	<b>3.Të mësuarit dhe mësimi</b>  ❖ Grupa punuese  ➤ Bukurie Selimi ➤ Jasmina Bojoska ➤ Lejla Gërble
<b>4.Përkrhja e nxënësve</b>  ❖ Grupa punuese  ➤ Ilinka Mihajloviq ➤ Latife Emini Hasani ➤ Zarie Ademi	<b>5.Etos (Klima e shkollës)</b>  ❖ Grupa punuese  ➤ Mjaftime Kadriu ➤ Lençe Simjanovska ➤ Verica Milloshevska	<b>6.Resurse</b>  ❖ Grupa punuese  ➤ Nehime Shishko ➤ Sejlan Arslani ➤ Sllavica Levkovska
<b>Drejtimi, udhëheqja dhe krijimi i politikës</b>  Grupa punuese  ➤ Valdeta Beqiri ➤ Olivera Rasdeska ➤ Juliana Jovanovska		

Çdo grup (tim) i arsimtarëve për secilën fushë për matjen e kualitetit për punën e shkollës shfrytëzonte indikator të përgatitura që më parë. Si burime të të dhënave shfrytëzoheshin: bisedat, pyetësorët (anketat) për nxënës, prindër, arsimtar, intervjuë qasje në dokumentacionin dhe evidenc pedagogjike dhe analiza e dokumenteve të lartpërmendura.

### **Propozim masa për përmirësimin e kualitetit të punës së shkollës**

- ❖ Përsosja profesionale e arsimtarëve, të cilët do të realizojnë mësimin sipas plan-programeve të reja mësimore;
- ❖ Nxitja e nxënësve për pjesmarrje më të madhe në gara;
- ❖ Aplikimi i metodave dhe formave bashkëkohore për notim në mësim nga të gjithë arsimtarët;
- ❖ Përparimi i bashkëpunimit me prindërit e nxënësve të cilët tregojnë sjellje joadekuate në shkollë ( këshillimore me prindërit e realizuar nga pedagogu i shkollës );
- ❖ Furnizimi me literatur profesionale dhe lektyra.

## Indikatorët për punën kualitative dhe të sukseshmenë shkollë

Fusha 1. Planë-programet mësimore		
Niveli i evaulimit: <u>Shumë mirë</u>		
Nr.	Indikatorët për kualitet	Temat
1.1	Realizimi i planeve dhe programeve mësimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Aplikimi i planeve-programeve mësimore;</li> <li>❖ Informimi i nxënësve dhe prindërve për plan-programet mësimore;</li> <li>❖ Përzgjedhja e plan-programeve mësimore;</li> <li>❖ Përgatitja e planeve mësimore individuale për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;</li> <li>❖ Planifikimi i aktiviteteve për realizimin e orëve të lira-aktivitetet e shkollës në projekte të ndryshme;</li> <li>❖ Realizimi i programeve të zgjeruara</li> </ul>
1.2	Kualiteti i plan-programeve mësimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Barazia gjinore dhe sensibiliteti multikulturor i plan-programeve mësimore dhe mjeteve tjera mësimore ;</li> <li>❖ Integrimi i qëllimeve të përgjithshme arsimore (mnë mes të lëndëve );</li> <li>❖ Integrimi i karakteristikave dhe nevojave të rrethit lokal në plan-programet dhe mjetet ndihmëse;</li> <li>❖ Ndikimi i arsimtarëve dhe prindërve në plan-programet mësimore.</li> </ul>
1.3	Aktivitetet jashtë mësimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Volumi dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara të aktiviteteve jashtë mësimore;;</li> <li>❖ Përfshirja e nxënësve në Aktivitetet e lira;</li> <li>❖ Përfshirja e nxënësve në zgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet e lira;</li> <li>❖ Afirmimi i nxënësve dhe shkollës përmes aktiviteteve të lira ( aktivitetet jashtëmësimore).</li> </ul>

## Burimi i të dhënave

- Plane dhe programe të sjella nga B.ZH.A
- Planifikimet vjetore-tematike për arsimtarët
- Aktet normative të shkollës
- Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike
- Proçesverbale nga këshilli i prindërve në shkollë
- Proçesverbale nga takimet e prindërve
- Proçesverbale nga këshillat e arsimtarëve dhe aktivet profesionale
- Programi vjetor i shkollës
- Udhëzime dhe rekomandime profesionale për operacionalizimin e plan-programeve mësimore
- Thirrjet për pjesmarrje në seminare
- Raporte nga prindërit e anketuar të nxënësve
- Lëndët zgjedhore të përfaqësuar nga paralelet
- Ditaret e paraleleve
- Proçesverbale nga puna e seksioneve
- Përgatitjet për gara
- Programe me ndryshime sistematike të sjellura nga B.ZH.A. dhe M.A.SH.
- Broshura
  
- Aktivet profesionale
- Aktet normative të shkollës
- Biseda me arsimtarët dhe prindërit
- Proçesverbale nga aktivet profesionale
- Itervist me Drejtorin
- Anketa me arsimtarët, nxënësit dhe prindërit
- Programe të sjellura me ndryshime sistematike nga B.ZH.A dhe M.A.SH.
  
- Bised me drejtorin
- Bised me arsimtar, nxënës dhe prindër
- Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike
- Puna e seksioneve
- Programa për M.P. , M.SH. dhe A.K.L. në mësim.
- Lëvdata
- Programa Vjetore për punën e shkollës



- Diploma
- Anketa
- Bised me shërbimin profesional

### 1.1.Realizimi i plan-programeve mësimore

Niveli gjatë evaulimit: Shumë mirë

Informacione të cilat janë mbledhur.

#### ❖ Zgjedhja dhe aplikimi i plan-programeve mësimore

Mësimi në SH.F.K. në përgjithësi organizohet dhe realizohet në pajtueshmëri (përputhje) me planin mësimorë për arsim fillor (nëntëvjeçar). Gjatë realizimit të programeve mësimore nuk ka ndryshime ( lëshime ) nëpër Lëndët mësimore atje ku nuk ka kushte programa realizohet në tërësi, por me kushte të inprovizuara ( adaptuara ).

Planet dhe programet të sjella nga M.A.SH. dhe B.ZH.A. janë në dispozicion të gjithë arsimtarëve, me kohë janë të informuar për ndryshimet dhe plotësimet të plan-programeve mësimore në fillim të vitit shkollor nga ana e shërbimit profesional të shkollës.

Në shkollë mësimi i lëndëve: matematikë, shkencat natyrore, fizika, kimia dhe biologjia realizohen në bazë të programeve mësimore të adaptuara sipas programeve të Qendrës Ndërkombëtare për programe mësimore Kembrixh (Cambridge International Examination Center) .

Të gjithë arsimtarët para fillimit të vitit shkollor përgatisin plane vjetore globale, tematike dhe planifikime procesuale nga të gjitha lëndët dhe aktivitetet jashtë mësimore. Të njejtat më së voni deri më 15 shtator dorëzohen te shërbimi profesional I shkollës. Drejtori dhe shërbimi profesional bëjnë ndjekjen e situates në lidhje me dorëzimin në kohë të planeve, kompletimin dhe kualitetin e të njejtave. Për këtë vit shkollor gjithçka ishte në rregull.

Planet dhe programet mësimore janë në përputhshmëri të plotë me dokumentet e sjellura nga MASH me qëllim të realizimit të gjithëmbarshëm të procesit edukativo-arsimor. Të njejtat gjatë tërë vitit gjenden në hapsirat e shërbimit profesional dhe janë në dispozicion për të gjithë arsimtarët dhe prindërit.Nxënësit për të njejtat janë të njohtuar përmes planifikimeve tematike dhe orës së klasës.Planet dhe programet mësimore realizohen përmes mësimit bashkëkohorë të shek.21 me arritje të zhvillimit dhe edukimit maksimal të arsimtarëve dhe nxënë sve (notimi formativ dhe sumativ).

Gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore numri më i madh i arsimtarëve në mënyrë aktive i aplikojnë metodat e reja mësimore për realizimin e përmbajtjeve,metodat për ndjekjen dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve dhe përdorimin e TIK në mësim.

Në planet mësimore janë të kyçura edhe metodat për ndjekjen e të ariturave të nxënësve ( notimi formativ-sumativ ) . Me sukses realizohet edhe programa për integrimin e EKO-STANDARDEVE në procesin mësimor.

Në mësimin klasor ka mundësi për qasje integrative të përmbajtjeve, e njejtat përdoret shpesh. Më së shpeshti integrohen përmbajtjet nga shkencat natyrore, gjuha amëtare dhe arsimit figurativ si dhe aplikimi i TIK në mësim.

Rregullisht shfrytëzohet softveri Toolkit, G-Comprice, E-School dhe interneti, në mësimin lëndor ka mundësi minimale për realizimin e mësim

integrativ për këtë shkak kjo bëhet në disa lëndë. Ndikim më të madh për mënyren e realizimit të programeve mësimore kanë arritur përmes përdorimit të formave dhe metodave të ndryshme të punës në harmoni me projektet në të cilat është e kyçur shkolla. Në shkollë ka inkluzion të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore gjithashtu në orët e klasës realizohen përbajtje nga shkollësitë jetësore. Në planet dhe programet mësimore realizohet edhe TIK. Ndërthurur edhe përbajtjet nga projekti “Matematika me të menduar”, integrimi ndëretnik në arsim, integrimi në EKO përbajtje, Paketi i gjelbërt Xhuniar si dhe projekti “Me lexim deri në lider”.

#### ➤ **Informimi i prindërve dhe nxënësve për planet dhe programet mësimore**

Shkolla kujdeset që prindërit me kohë të njohtohen për planin mësimor dhe përbajtjet e saj dhe pse interesimi i prindërve është i dobët d.m.th. nuk kënaq. Para fillimit të çdo viti shkollor, shkolla përgatit Program Vjetor në të cilën i planifikon aktivitetet e gjithëmbarshme për realizimin e planeve e programeve mësimore dhe aktiviteteve të lira. Në planin vjetor janë dhënë edhe prioritetet e shkollës të cilat dalin nga qëllimet afatgjate të cilat janë dhenë në planin zhvillimor të shkollës. Programi vjetor shqyrtohet nga ana e arsimtarëve, Këshilli i shkollës, këshilli Drejtues, SH.F.K. e dëgjon pastaj në Këshillin komunal që të miratohet e njejta. Kjo procedurë respektohet me kujdesë. Bashkëpunimi me prindërit realizohet në suaza të planifikimit të takimeve me prindërit dhe këshillimet me prindërit që i realizon shërbimi profesional. Në programin vjetor planifikohen edhe ekskursionet e nxënësve të cilat bazohen në rregulloren për realizim të të njejtave para realizimit arsimtarët i respektojnë të gjitha kërkesat në harmoni me rregulloren për realizimin e të njejtave. Të gjitha ekskursionet finansohen nga prindërit. Prindërit njohtohen përmes këshillit të prindërit dhe takimet me prindërit. Diturit e arritura në mësimin e rregullt dhe jo të mësuar, nxënësit i prezantojnë përpara moshatarëve dhe prindërve gjatë shënimit të manifestimeve të ndryshme. Nxënësit marrin pjesë në të gjitha garat e organizuara në nivel lokal, regjional dhe shtetëror si dhe gara të organizuara nga ndonjë institucion ( kolegji ).

Puna e dobishme shoqërore realizohet në harmoni me aktivitetet e planifikuara në programin e shkollës si dhe pjesëmarrjen në aktivitete të planifikuara nga rrethi lokal.

Këto aktivitete realizohen si rregullimi i oborrit të shkollës, patatj dita e ekologjisë, dita e drurit, dita e Planetit Tokë etj. Bashkësia e nxënësve ( dhe organizatat tjera ) prej klasës së parë ( dhe organizatat tjera ) prej klasës së I-rë-IX-të aktivitetet i realizojnë sipas programeve të përgatitura paraprakisht edhe atë në nivel të paraleles së kordinuar nga kujdestarët e klasave dhe arsimtarët përgjegjës. Shkolla kujdeset edhe për shëndetin e nxënësve të bazuar në politikën shëndetësore të shkollës bashkëpunimeve me Shtëpinë e shëndetit në rrethin lokal. Shkolla kujdeset për informimin e nxënësve në kohë për temat aktuale të shëndetësisë, ndjekja dhe organizimi i kontrolleve sistematike ( gjatë shkollimit të secilit fëmijë ), imunizimi dhe kontrolli të rregullt të dhëmbëve ( stomatolog ). Gjatë tërë vitit shkollorë shërbimi profesional i shkollës në programin e vet planifikon aktivitete për edukimin shëndetësorë të nxënësve.

#### ➤ **Përzgjedhja e plan-programeve mësimore**

Në shkollë ofrohen lëndë zgjedhore për të mësuar, lëndë të cilat janë të parapara sipas planit mësimor. Ato përzgjidhen më deklarata me shkrim përmes anketave që u shpërndahen prindërve të të gjithë nxënësve. Çdo lëndë zgjedhore hynë në mësim pasi të jetë formuar grup mësimor. Kujdestarët e klasave në mësim lëndor dhe arsimtarët klasor në orën e bashkësisë së klasës punojnë sipas programës për Shkathtësi jetësore.

#### ➤ **Përpunimi i planeve arsimore individuale PAI për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.**

Shkolla i kushton kujdesë të veçantë inkluzimit ( gjegjësisht ) Të fëmijëve më nevoja të veçanta perms projektit “Shkolla inkluzive”. Përgatiten plane enkas për këto fëmijë nga ana e arsimtarëve në bashkëpunim me shërbimin profesional dhe prindërit. Këto programe kanë qasje të diferencuar të bazuara në mundësitë e këtyre fëmijëve.

➤ **Panifikimi i aktiviteteve për realizimin e orëve ( aktiviteteve ) të lira në shkollë.**

Në shkollë realizohen numër i madh i aktiviteteve jashtëmësimore, aktivitete në realizimin e projekteve të ndryshme edhe atë: Punë në sekcione, organizata, mësim shtues, projekte hulumtuese, aktivitete projektuese në të cilat janë të përfshira njëlloj nxënës të të dyja gjinive edhe atë nga të gjitha bashkësitë etnike. Në mësimin jashtëmësimor janë të përfshirë nxënës me aftësi të ndryshme psikofizike dhe nxënës me nevoja të veçanta.

Në shkollë realizohet numr i madh i aktiviteteve multietnike projektet e fituara nga grande të ndryshme në bashkëpunim me bashkësinë lokale si dhe pjesëmarrje në festivale të organizuara në MASH, USAID dhe MCGO, poashtu edhe në aksione rinore për regullimin e rrethit lokal.

Bazuar në këto aktivitete shkolla jonë fitoi grandin e madh për rregullimin e sallës sportive.

Me realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore shkolla u afirmua me atë që fitoi numër të madh të lëvdatave, shpërblimeve në shumë vende të para edhe atë në nivel komunal, regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar.

➤ **Realizimi i programe të zgjeruara**

Në suaza të programës së zgjeruar realizohet pritja dhe kujdesi për nxënësit një orë para fillimit të orëve dhe një orë pas mbarimit të mësimit të rregullt, e cila përfshinë pranimin e nxënësve, shoqërimin, përgatitken për të shkuar në shtëpi dhe takime më prindërit.

Për të gjitha solemnitetet që organizohen në shkollë me rast të festave si: Dita e alfabetit, 28 Nëntori, Viti i Ri, 8 Marsi, Patronati i shkollës etj. Nxënësit përgatiten në AKL të cilat realizohen nën përkujdesjen e arsimtarëve përgjegjës të cilët kanë plan të përgatitur që më parë. Aktivitetet jashtëmësimore organizohen për nxënësit q[ sipas afiniteteve të tyre personale të marrin pjesë në to. Nxënësit nuk janë të kufizuar, por as të diskriminuar në regjistrimin e ndonjëres prej aktiviteteve jashtëmësimore.

## 1.2 Kualiteti i plan-programave mësimore

### Niveli i evaulimit: Shumë mirë

Informacione të cilat janë grumbulluar

#### ❖ E drejta gjinore-etnike dhe sensualitet multikulturor e programeve dhe mjeteve mësimore

Plan-programa e arsimtarëve për të drejtat gjinore-etnike në përgjithësi për zhvillimin shoqëror të nxënësve femra dhe meshkuj të etniteteve të ndryshme për pjesmarrje të barabartë, realizohet përmes: përmbajtjeve të arsimit për Shkathtësi Jetësore, kulturës qytetare, temave të caktuaranë orën e bashkësisë së klasës në bashkëpunim me shërbimin profesional pedagogjiko-psikologjik. Poashtu në shkollë funksionon edhe programa për menaxhimin e sjelljeve të dhunshme në shkollë.

#### ❖ Integrimi i qëllimeve arsimore ( përmes lëndëve )

#### ❖ Integrimi i qëllimeve përmes lëndëve janë të përfshirë në më shumë programe.

Integrimi i qëllimeve përmes lëndëve janë të përfshirë në më shumë programe.

Arsimtarët marrin udhëzime nga bashkëpunëtorët profesional sipas të cilave do të kryhen integrimi lëndorë në planifikimet e arsimtarëve. Në planet dhe programet e orëve të bashkësisë së klasës janë të planifikurapërmbajtje nga fusha e shëndetësisë të cilat mundësojnë arritjen e njohurive për shëndetin dhe përparimin e saj, aftësimin e nxënësve për jetë të shëndoshë diskutohe t për sukses, rregullsi, discipline, ekologji dhe tema të tjera të cilat i propozojnë nxënësit në harmoni me moshën e tyre.

#### ❖ Integrimi i karakteristikave dhe nevojave të rrethit lokal në plan-programet dhe mjetet tjera mësimore

Gjatë përpunimit të plan-programeve nëpër lëndë dhe gjatë përpunimit të programës vjetore të shkollës theks i posaçëm i kushtohet integrimin të karakteristikave dhe nevojave të rrethit lokal në plan-programet e arsimtarëve. Realizimi i këtyre integritimeve bëhet përmes: vizitave hulumtuese ekspozitive, vizitës së institucioneve prodhuese dhe arsimore: muzejeve, bibliotekave, djekjae shfaqeve teatrale, vizita e hapësirave në komunë. Shkolla e jonë në kontekst të realizimit të disa përmbajtjeve në lëndë të caktuara bashkëpunon me MPM përmes të ligjerimit të temave nga komunikacioni etj. Shkolla bashkëpunon edhe më shtëpinë e shëndetit bëhet vaksinimi i rregullt dhe kontrollet sistematike të nxënësve kontrolle të dhëmbëve si dhe organizimi i punëtorive me tema të ndryshme.

Shkolla organizon ligjerata për marëdhëniet gjinore dhe lidhjet e tyre seksuale shëndetin reproduktiv, sëmundjet HIV-SIDA dhe droga.

❖ **Ndikimi i arsimtarëve dhe prindërve në plan-programet mësimore**

Shkolla është e hapur për ndryshime dhe realizon proekte të cilat e bëjnë më efikase dhe bashkëkohore. Kjo më së miri vërehet në atë se Shkolla si në mësimin lëndor, por edhe në atë klasor aplikon mbajtjen e evidencën e dokumentacionit. Nga ana e BZHA dhe MASH organizohen seminare për edukimin e arsimtarëve. Me analizat e plan-programeve vërtetohet se arsimtarët bëjnë disa ndryshime në realizimin e disa përmbajtjeve mësimore.

Në shkollë funksionojnë aktive nga të gjizha lëndët mësimore të grupuara si: Aktive të arsimtarëve klasor prej kl.I-V, pastaj ato lëndorë në grupe të aktiveve matematiko-natyrore si dhe të lëndëve shoqërore. Të njejtat i prezentojnë procesverbalet e mbajturanga mbledhjet në të cilat vërehet ndihma reciproke midis arsimtarëve të cilët kanë ndjekë seminare dhe trajnime. Nga ditaret kontrolluara shihet se gjithëçka është planifikuar është realizuar. Shkolla mban llogari që arsimtarët me t'i lajmërojnë për ndryshimet në plan-programet mësimore.

### 1.3. Aktivitetet jashtëmësimore

Niveli i evaulimit: **Shumë mirë**

Informacione të cilat janë grumbulluar

❖ **Volumi dhe shumëllojshëria e planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve jashtëmësimore**

Fusha e aktiviteteve jashtëmësimore në shkollën tonë përfshinë: AKL, ekskursione, bashkësinë e nxënësve, punën e dobishme shoqërore, shëndeti i nxënësve dhe garate nxënësve.

Shkolla ofron spektër të gjërë të AKL-së përmes të cilave nxënësit kanë mundësi t'i plotësojnë intereset dhe aftësitë e tyre. Nxënësit në fillim të vitit shkollorë sipas interesimit dhe afiniteteve të tyre lirisht mund të regjistrohen në seksionet e dëshiruara edhe atë jo më shumë se në dy seksione. Në shkollën tonë ekzistojnë këto seksione: i gjuhëve të huaja ( anglisht-Gjermanisht ), matematicientët e rinj, teknikët e rinj, biologët e rinj, fizicentët e rinj, gjeografët e rinj, historianët e rinj, seksioni i komunikacionit-teknik, literaturo-dramatike, ajo e artit figurativ, muzikës, seksioni për hendboll dhe futboll të vogël.

➤ **Përfshirja e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore**

Nxënësit zgjedhin seksionin sipas afinitetit, nuk janë të diskriminuar. Me këtë mundësohet kyçja e një numri të madh të nxënësve në këto aktivitete. Poashtu nga këto aktivitete nuk janë të privuar as nxënësit me status të ulët socio-ekonomik.

➤ **Përfshira e nxënësve në përzgjedhjen e aktiviteteve jashtëmësimore**

Nxënësit bëjnë vetëzgjedhjen, planifikimin dhe organizimin e punës nëp[er seksione roli i arsimtarit është udhëheqës dhe konsultues.

➤ **Afirmimi i nxënësve dhe i shkollës përmes shkathësive jashtëmësimore**

Nxënësit çdoherë nxiten dhe përkrahen në pjesëmarrjen e tyre në gara të ndryshme si të nivelit lokal, regjional dhe republikan e ndërkombëtarë.

**Metodat tjera për mbledhjen e të dhënave**

**(Pyetësor, anketa, të vërejturit)**

Metoda për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrje në mbledhjen e të dhënave	Informacionet të cilat janë grumbulluar
Bisedë me arsimtarët	Arsimtar nxënës	Arsimtarëve planet dhe programet mësimore u janë përgatitur nga BZHA-ja, seminare dhe këshillimore. Në seminare marrin informacione më konkrete për planet dhe programet mësimore, në planifikimet tematike dhe realizimin operativ të njësive mësimore. Me realizimin r aktiviteteve jashtëmësimore rritet, motivimi kreativiteti, socializimi përmes pjesëmarrjeve në konkurse, gara të niveleve të ndryshme, kështu afirmojnë shkollën dhe veten. Në punët rrjedhëse vërehet pjesëmarrje më e madhe në konkurse, gara të diturisë, të sportit edhe atë në të gjitha nivelet.

Bisedë me prindërit	Anëtarët e timit për vetëevaulimin e shkollës	Prindërit në takimet me prindër informohen për plan-programet mësimore dhe me lëndët që do të mësohen gjatë vitit shkollor. Për veç kësaj informata më detale nuk kanë ,por edhe interesimi i prindërve në këtë aspekt nuk kënaq.
Bisedë me pedagogun dhe psikologun	Anëtarët e timit për vetëevaulimin e shkollës	Arsimtarëve iu rekomandohet të shfrytëzojnë literaturë dhe revista të ndryshme ku më detajisht të njoftohen me tema të përpunuara profesionalisht. Përdorimi i këtyre literaturave sjell në përmirësimin e kualitetit të plan-programeve mësimore.
Bisedë me drejtorin dhe shërbimin profesional	Anëtarët e timit për vetëevaulimin e shkollës	Arsimtarët i kanë në dispozicion edhe plan-programet nga MASH-i dhe në bazë të tyre përgatisin plan-programet mësimore që i dorëzojnë te shërbimi profesional i shkollës.
Bisedë me shërbimin profesional dhe me drejtorin	Anëtarët e timit për vetëevaulimin e shkollës	Eksiston bashkëpunimi në mes të nxënësve pamarr parasysh përkatësin e tyre gjinore etnike e kulturore si rezultat i kësaj marrëdhëniet mes fëmijëve janë në nivel të lartë

### REZULTATET

<b>Fusha 2. Arritjet e nxënësve</b>	
<b>Niveli i evaulimit: <u>Shumë mirë</u></b>	
Indikatori i kualitetit	Temat
2.1 Arritjet e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Mbikqyrja e arritjeve të nxënësve të gjinive të ndryshme të nxënësve sipas temës mësimore dhe sipas periudhës së kualifikimit.</li> <li>❖ Përmirësimi i arritjeve të nxënësve të gjinive të ndryshme .</li> <li>❖ Identifikimi i nxënësve me vështirësi në mësim nxënës të talentuar,dhe nxënës me nevoja të veçanta.</li> <li>❖ Përmirësimi i arritjeve të nxënësve nëpërmjet mësimit shtues,plotësues dhe aktiviteteve të lira.</li> <li>❖ Mbikqyrja e arritjeve të nxënësve gjatë kalimit nga njëri cikël në tjetër,dhe nga një nivel në tjetër</li> </ul>
2.2 Qëndrimi/ largimi i nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Përfshirja e nxënësve.</li> <li>❖ Rregullsia në mësimdhënie.</li> <li>❖ Largimi i nxënësve.</li> <li>❖ Kalimi i nxënësve nga njëra në shkollë tjetër.</li> </ul>
2.3 Përsëritja e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Nxënës që përsërisin vitin.</li> </ul>



## Burimet e të dhënave

- Ditari i paraleles.
- Fletë evidentuese për arritje dhe sjellje.
- Mbikqyrja e suksesit nga tremujori.
- Proçesverbalet e këshillëve të mësimitdhënësve klasor dhe lëndor.
- Anketimi i mësimitdhënësve, prindërve dhe nxënësve.
- Proçesverbalet nga aktivitetet profesionale.
- Programi vjetor për punë.
- Raport për punën e shkollës.
- Raport nga shërbimi profesional.
- Programi për mësimin shtesë dhe plotësues.
- Të dhënat dhe raportet nga shërbimi pedagogjik-psikologjik.
- Të dhënat nga mësimitdhënësit klasor dhe lëndor.
- Të dhënat nga shërbimi administrativ (sekretar) dhe libri amzë.
- Programi për punë dhe raporti i punës së shkollës.
- Lista e nxënësve nga vendbanimi.
- Njoftime nga MASH dhe inspektoriati arsimor.
- Intervistë me shërbimin profesional.
- Pasqyrë e të dhënave pedagogjike dhe dokumentacioni.
- Proçesverbali nga këshilli i mësimitdhënësve.
- Raport vjetor për punën e shkollës.
- Ligji për arsimin fillor.

## 2.1 Arritjet e nxënësve

### Niveli i evaulimit: Shumë mirë

#### Informata të grumbulluara

- ❖ Mbikqyrja e arritjeve të nxënësve të gjinive të ndryshme të nxënësve sipas temës mësimore dhe sipas periudhës së kualifikimit.

Shkolla i ndjek arritjet e nxënësve gjatë referimit të secilit arsimtarë në këshillet lëndore dhe klasore sipas procedurës së vërtetuar paraprakisht të shkruar, dhe ka në dispozicion të dhëna për arritjet e nxënësve sipas gjinisë, përkatësisë etnike, lëndëve, dhe gjuhës mësimore prej tabelave të përgatitura të periudhës kualifikative (viti shkollorë 2017/18 dhe 2018/19). Në shkollën tone mësimi zhvillohet në gjuhën maqedone, shqipe dhe turke.

Shërbimi profesional i shkollës mban të dhënat e veta për ndjekjen e nxënësve gjatë vitit shkollorë. Këshilli i arsimtarëve mbahet katër herë gjatë vitit shkollorë me këtë rend dite: realizimi i plan-programës, rishikim i arritjeve të nxënësve në çdo periudhë kualifikimi, propozim dhe masa për përmirësimin e suksesit dhe disiplinës (organizimi i mësimit plotësues në lëmitë ku nxënësit ngecin dhe kanë sukses të dobët), biseda këshilluese individuale apo grupe me nxënës me sukses të dobët nga ana e shërbimit profesional shkollorë, diskutime me prindërit e nxënësve me sukses të dobët. Rishqyrtohen notat e nxënësve nga secila lëndë, ndërsa nxënësit me sukses të ulët trajtohen sipas masave të propozuara p.sh: takime me prindërit, bisedë me kujdestarin e klasës, psikolog etj. Për arritjet e nxënësve suksesin dhe sjelljen, prindërit informohen mbledhje prindërore, me anë të fletëve evidentuese, me anë të ditarit elektronik në të cilët gjithashtu mundën të ndjekin arritjet e nxënësve, dhe në fund të vitit shkollorë me dëftesë për mbarim të vitit shkollorë.

Arritjet e nxënësve për çdo periudhë kualifikimi (qofshin ato pozitive apo negative) publikohen për të gjithë nxënësit, ndërsa arritjet nëpër gara të ndryshme, konkurse e të ngjashme promovohen publikisht në shfaqje dhe në fund të vitit shkollorë. Këto arritje të nxënësve regjistrohen në raportin vjetor të shkollës. Mësimdhënësit nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare dhe stërvitje, përgatiten për aplikimin e inovacioneve në procesin mësimor si dhe në vlerësimin e arritjeve të nxënësve. Të gjithë mësimdhënësit aplikojnë metoda moderne për vlerësim-notim (fletë evidentuese, shkallë vlerësimi, portfolio etj) zbatohet vlerësimi formativ dhe sumativ (përmbledhës) me një kuptim më të madh të arritjeve të nxënësve.

- ❖ Vijon raporti për gjysëm vjetorin për vitin shkollorë 2018/19.
- ❖ Vijon raporti vjetor për vitin shkollorë 2018/19.
- ❖ Përmirësimi i arritjeve tek nxënësit të gjinive të ndryshme.

Për përmirësim të arritjeve tek nxënësit, mësimdhënësit zbatojnë forma dhe metoda të ndryshme aktive të punës, teknika kreative, përdorimi i TIK në mësim dhe eko-standardeve. Me gjitha këto orët janë më interesante, komunikimi zhvillohet në nivel më të lartë dhe mundësohet ndihmë më e madhe nga ana e mësimdhënësit. Gjatë notimit bëhet përpjekje për transparencë më të madhe, vlerësim formative dhe përcjellje të nxënësve duke kontribuar në një objektivitet dhe drejtësi. Suksesi mesatar i shkollës shënon prirje të ngritjes.

Rol të rëndësishëm për përmirësimin e suksesit, sipas analizave nga ana e shërbimit profesional kanë nxënësit dhe garat jashtëmësimore (të dijes, artit dhe sportit) kuize, pjesëmarrje në konkurse të ndryshme, konkurse dhe gara shtetërore, pjesëmarrja e nxënësve në projekte shkollore, përdorimi i metodave moderne në punë nga ana e mësimdhënësve, ndryshimi i mënyrës së mësimdhënies etj. Rritje të dukshme të arritjeve të nxënësve në nivel individual vërehet në raste ku ekziston angazhim më i madh i prindërve për fëmijën e vet. Shkolla ndërmer përpjekje për të rritur përfshirjen e prindërve në monitorimin e suksesit të fëmijëve të tyre përmes takimeve të përgjithshme dhe individuale prindërore.

- ❖ Identifikimi i nxënësve me vështirësi në mësim, nxënës të talentuar dhe nxënës me nevoja të veçanta.
- ❖ Përmirësimi i arritjeve të nxënësve nëpërmjet mësimin shtues, plotësues dhe aktiviteteve të lira.

Në shkollë përkrah mësimin të rregullt organizohet mësim plotësues dhe shtues për punë me nxënës që hasin vështirësi në mësim, respektivisht përparojnë më shumë krahasuar me tjerët. Me anë të llojit të tillë mësimorë ju mundësohet nxënësve që kanë vështirësi të përballojnë materialin më lehtë dhe me ndihmën e mësimdhënësit, si dhe me ushtrime plotësuese t'i kuptojnë përmbajtjet të cilat vetë nuk mund t'i përballojnë. Përderisa nxënësve të cilët përparojnë, ju ofrohet mundësia të punojnë detyra më të komplikuar dhe të përfitojnë dituri të nivelit më të lartë.

- ❖ Mbikqyrja e arritjeve të nxënësve gjatë kalimit nga njëri cikël në një tjetër, dhe nga një nivel në tjetër.

Nëse analizohet suksesi i arritur prej klasës së pestë në të gjashtë, tek nxënësit e njejtë vërehet ulje e suksesit. Supozohet se faktor të mundshëm mund të jenë: qëndrimi tolerant i mësuesve klasorë gjatë notimit të nxënësve të klasës së pestë, kriteriumet e ndryshme gjatë notimit të mësimdhënësve klasor në krahasim me ato lëndor, kalimi dhe adaptimi i nxënësve prej mësimin klasor në lëndor të cilat vijnë me vështirësi të vetë nxënësit të cilët vijnë nga rrethina të ndryshme etj. Në shkollën tone bëhet krahasimi i arritjeve të nxënësve në fund të çdo viti shkollorë për lëndë dhe klasa, dhe në këtë mënyrë vërtetohen arritjet më të larta apo më të ulta nga viti i kaluar. Përderisa paraqitet dallim më i theksuar në arritjen e nxënësve, shkolla i analizon shkaqet e kësaj dukurie, merr masa dhe aktivitete për t'i tejkaluar të njejtat.

Shkolla nuk ka të dhëna për atë se si është suksesi i nxënësve të klasave të IX të cilët shkollimin e kanë vijuar në shkolla të mesme, por si detyrë prioritare kyçet kjo ndjekje për vitet shkollore në vijim. Gjatë notimit të nxënësve mbështeten standardet dhe kriteriumet për notim të dhëna nga Byroja e arsimit dhe të njejtat ju kumtohen nxënësve në fillim të vitit shkollorë me qëllim që të jenë saktësisht të informuar me mënyrën e notimit. Nxënësit 100% e mbarojnë shkollën fillore dhe të njejtët e vazhdojnë arsimimin në shkollë të mesme. Nga informatat të cilat i merr shkolla nga shkollat e mesme, shihet se nxënësit tone arrijnë rezultate të mira, dhe të njejtët e mbarojnë arsimimin e mesëm, por, për fat të keq, pamundësia ekonomike ndikon që një pjesë e madhe e nxënësve përkrah dëshirave të tyre nuk mundën që t'a vazhdojnë

arsimimin e tyre në ndonjë univerzitet shtetëror.

## 2.2. Qëndrimi/ largimi i nxënësve

Niveli i evaulimit: Shumë mirë

Informacione të grumbulluara

### ❖ Përfshirja e nxënësve

Gjatë regjistrimit të nxënësve shkolla jonë mundëson që t'i pranojë të gjithë nxënësit që jetojnë në rrethinën e shkollës qendrore dhe ato periferike.

Gjatë viteve në vazhdim numri i nxënësve zvogëlohet si në shkollën qendrore ashtu edhe në ato periferike. Shkaqet për një dukuri të tillë janë: migrimi i familjeve jashtë vendit (kryesisht të kombësisë shqiptare), zvogëlimi i numrit të martesave, zvogëlimi i natalitetit në nivel të vetë komunës dhe shpërngulja prej një vendi në vend tjetër.

Për regjistrim në kohë të klasave të para, shkolla i informon prindërit dhe banorët nëpërmjet lajmërimeve, raportohen nxënësit (se ka filluar regjistrimi i klasave të para) dhe takime informative çdo ditë pune prej orës 7 deri në ora 17.

### ❖ Rregullsia në mësim

Me anë të raporteve prej kujdestarëve të klasave dhe raporte tjera nga shërbimi profesional, shkolla rregullisht e ndjek rregullsinë e nxënësve në mësim, i analizon shkaqet e mungesave në orë që të mundet në kohë të mer masa dhe aktivitete për përmirësimin e rregullsisë së nxënësve. Sipas të dhënave nga raportet, në kohë të fundit është vërejtur mungesë më e ulët në mësim që është meritë e bashkëpunimit në mes shkollës nga njëra anë dhe prindërit nga ana tjetër, përmes këshillimit prindërit e nxënësve të cilët për shkaqe të ndryshme manifestojnë jorregullshmëri në shkollë. Si rezultat i këtyre aktiviteteve shkolla pret që në të ardhmen edhe më shumë të zvogëlohet numri i mungesave të nxënësit.

### ❖ Largimi i nxënësve

Largimi i nxënësve nga shkolla jonë është si rezultat i shpërnguljes në vende të jashtme ndërsa kalimi në shkolla tjera është e parëndësishme.

### ❖ Kalimi i nxënësve nga njëra në shkollë tjetër

Gjatë kalimit të nxënësve nga njëra shkollë në tjetër respektohet ligji d.m.th. mbahet rregullisht evidence pedagogjike dhe e dokumenteve. Në kohë dorëzohet informacion për nxënësit dhe i njejtë merret parasysh gjatë vazhdimit të shkollimit të nxënësit. Nxënësit i cili çregjistrohet ose vjen prej shkollës tjetër i jepet fletëshpërngulje. Në fletëshpërngulje shënohen të dhënat e shkollës fillore, vendi, komuna, numri i librit amzë viti

shkollorë,të dhënat personale për nxënësit,të dhëna për klasën që e ka ndjekur dhe sukseesi lëndor sipas planit mësimor,nota e sjelljes,mungesa dhe shkaqet që kanë ndikuar të ndalojë ndjekjen e mësimet,numri i protokolit,data,nënshkrimi i kujdestarit të klasës,drejtorit dhe vula e shkollës.

### 2.3 Përsëritja e nxënësve

Niveli i evaulimit: **Shumë mirë**

Informata të grumbulluara

#### ❖ Nxënës që nuk e kalojnë klasën

Sipas nenit 69 dhe 70 të Ligjit për arsim fillor,nxënësit prej klasës së parë deri në klasë të pestë nuk mundën që të përsërisin klasën përveç se nëse prindërit nuk insistojnë.Nëse nxënësit nuk arrijnë të menaxhojnë mësimet nga lëndët mësimore nga viti mësimorë për shkaqe të arsyeshme,me propozim të prindërit ose mësuesit klasorë dhe bashkëpunorëve professional të shkollës,nxënësi mundet të mbetet në klasë të njejtë,ndërsa vendimin e sjell këshilli i arsimtarëve të shkollës.Nxënësi i cili në fund të vitit shkollorë nga tremujori i tretë ka nota negative nga dy lëndë udhëzohet në riprovim,ndërsa shkolla ka për obligim të organizoj mësim plotësues në qershor.Nëse nxënësi mbas mësimit plotësues nuk arrinë sukses pozitiv(përmirësim)udhëzohet në provim të rishikuar i cili merret në korrik dhe gusht.Nëse nxënësi nuk e kalon provimin në njëjërën apo në të dy lëndët përsërit vitin shkollorë.

Disa vite në shkollën tone nuk ka pasur nxënës që përsërisin vitin.

Metoda tjera për grumbullimin e të dhënave(pyetsorë, anketa, hulumtime)		
Metoda për grumbullimin e të dhënave	Pjesmarje në mbledhje të informatave	Informacione të grumbulluara
Bisedë me drejtorin	Anëtarët e grupit të vetëevaluimit	Shkolla përmirëson arritjet e nxënësve përmes rregullsisë në zbatimin e vazhdueshëm të teknikave të reja mësimore,metoda të notimit të cilat vlerësojnë dituritë dhe arritjet e nxënësve,përdorimi i TIK në mësim,pjesmarjen e nxënësve në proekte,nxitje në mësim të pavarur nëpërmjet përpunimit të punëve proektore,mirëmbajtjen e rregullt e mësimit shtues,plotësues dhe aktiviteteve të lira.
Bisedë me drejtorin	Mësimdhënës të ekipit	Mësimdhënësit ndjekin dhe vlerësojnë dituritë individuale të nxënësve nëpërmjet teksteve në klasa të ndryshme,nga njëri vit shkollorë në tjetrin,nivelet teknike vërehen kur u jepen teste të diturive,fletë mësimore dhe instrumente të ndryshme për përcjellje të nxënësve sipas Taksonomisë së Blumit etj.
Bisedë me psikologun	Mësimdhënës,drejtor	Fëmijët me nevoja të veçanta në shkollën tone janë në numër të vogël,të njejt janë të kyçur në mësim të rregullt.Këto nxënës janë të mirëpritur nga ana e bashkmoshatarëve të tyre,të cilët ju ndihmojnë në përvetësimin e obligimeve shkollore.Mësimdhënësit që vlerësojnë me përshkrim kanë krijuar portfoli individuale për nxënësit ku mundet të perceptohet puna dhe arritja e nxënësve gjatë gjith vitit shkollorë.Shërbimi pedagogjik izbulon, evidenton dhe punon me nxënësit të cilët ngecin dhe kanë nevojë për ndihmë.
Vizitë në orë të hapura PEP	Mësimdhënës	Si rezultat i seminareve të mbajtura nga proekti PEP përafërsisht të gjithë mësimdhënësit e shkollës sonë janë stërvitur për përdorimin e metodave të reja mësimore,dhe metodave për ndjekje dhe vlerësim të nxënësve(formativ dhe sumativ).Gati se të gjithë mësimdhënësit mbajtën orë të hapura në të cilat u aplikuan teknika të reja inovative të mësimit,aplikimi i TIK,instrumente të ndryshme për ndjekje dhe notim të nxënësve si dhe vetëvlerësimin e tyre.Orë të tilla në të ardhmen do të mbahen më shpesh sepse këto orë eksperimentale,qartë treguan se me orë të tilla dinamike nxënësit janë më aktiv gjatë ores mësimore,është rritur motivimi i tyre për punë,ato vet zbulojnë terme dhe përmbajtje të reja,vetëvlerësohen.Një

		<p>mënyrë e tillë e punës pritet që të përmirësojë arritjet e nxënësve në një nivel më të lartë.Nxënësit jo vetëm që arrijnë rezultate më të mira por edhe fitojnë njohuri të qëndrueshme dhe cilësore.</p>
<p>Bisedë me mësimdhënës dhe nxënës</p>	<p>Anëtarët e grupit të vetëevaluimit</p>	<p>Gjatë punës mësimdhënësit kanë vërejtur se nxënësit janë më të suksesshëm aty ku kërkohet kreativitet dhe ku kanë mundësi për bashkëpunim,tregojnë aftësi për komunikim dhe atje ku kanë paranjohuri.</p> <p>Për përmirësim të paranjohurive propozohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Gjetja e mënyrës për rritje të motivimit te nxënësit dhe mësimdhënësit nëpërmjet lëvdatave,shprehjes së lire,debate etj.</li> <li>❖ Krijimi i ambientit për stimulim ku nxënësit me kënaqësi do të mësojnë.</li> </ul> <p>Nxënësit mendojnë se në shkollë me masë të madhe marin lëvdata sjelljet positive dhe suksesi i nxënësve.</p> <p>Gjithashtu mendojnë se mësimdhënësit parashtrojnë pritje të qarta për arritjen,rregullsinë dhe disiplinën e tyre.</p>

REZULTATET
<p><b><u>Pikat e forta</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Shkolla bashkëpunom me prindërit dhe ju jep informacione kthyesë për arritjet dhe disiplinën e fëmijëve të tyre.</li> <li>➤ Në shkollë në mënyrë sistematike dhe në kohë ndiqen dhe analizohen arritjet e nxënësve gjatë periudhëve të klasifikuaraklasa,paralele,lëndë dhe gjatë kalimit prej njërit në vitin tjetër mësimorë.</li> <li>➤ Gjatë notimit të nxënësve nuk vërehet dallimi i gjinisë apo përkatësisë etnike.</li> <li>➤ Arritjet e nxënësve nuk nvaren nga gjinia e tyre.</li> <li>➤ Është zvogluar ulja e suksesit dhe e arritjes në gjysëmvetorë.</li> <li>➤ 100% e nxënësve e përfundojnë ciklin arsimor.</li> <li>➤ Arritjet e nxënësve rregullisht theksohen publikisht.</li> <li>➤ Shkolla i përkrah standardet dhe kriteriumet për vlerësim të Byros së arsimit.</li> <li>➤ Numri i largimit të nxënësve gjatë vitit shkollorë është i vogël.</li> <li>➤ Nuk ka nxënës që rimarin klasën.</li> <li>➤ Arritja mesatare e nxënësve është e kënaqshme.</li> <li>➤ Nxënësit arrijnë rezultate shumë të mira në konkurse dhe gara ku marrin pjesë.</li> <li>➤ Nxënësit gjithashtu marrin pjesë në shumë gara letrare dhe lexime me veprat e tyre personale.</li> <li>➤ Nxënësit dhe prindërit rregullisht dhe në kohë informohen për arritjet dhe përparimin nga ana e mësimdhënësve.</li> <li>➤ Të gjithë nxënësit që kryejnë shkollimin fillor rregjistrohen në shkollë të mesme.</li> <li>➤ Janë përgatitur plane individuale për nxënës me vështirësi në mësim.</li> <li>➤ Shërbimi profesional është rregullisht i arritshëm për bashkëpunim me prindër nxënës dhe mësimdhënës.</li> <li>➤ Nxënësit e talentuar marrin pjesë në gara(komunale,regjionale,republikane).</li> <li>➤ Shkolla bashkëpunon me shërbime tjera profesionale dhe institucione nga bashkësia lokale.</li> </ul>
<p><b><u>Pika të dobëta</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Nuk është ndërtuar sistem për ndjekje të arritjeve të nxënësve pas mbarimit të arsimit fillorë.</li> <li>➤ Nuk është bërë analizë mbi pabarazinë gjinore në lidhje me suksesin e arritur në të gjitha lëndët.</li> <li>➤ Mungesë e shërbimit profesional të defektologut dhe punëtorit social për nxënës me vështirësi në mësim.</li> <li>➤ Si rezultat i mungesës së kabineteve për mësim ka pengesa në motivimin e nxënësve për arritje më të larta në mësim brenda vetë klasës.</li> </ul>



**Analiza mbi rezultatet**

Shkolla jonë në përgjithsi i ndjek arritjet dhe nevojat e nxënësve dhe bashkëpunon me prindërit e tyre, me çka dhe ju jep informacione detalore për to. Bashkëpunimi me shërbimet profesionale dhe institucionet e bashkësisë lokale është në nivel të dukshëm.

Shkolla i përmirëson arritjet e nxënësve me mësim të rregullt, zbatim të teknikave dhe metodave të reja mësimore. Merren masa për involvim më të madh të prindërve dhe ndjekjen e suksesit të fëmijëve të tyre. Mësimdhënësit bëjnë vlerësim individual të diturive të nxënësve sipas standardeve dhe kriteriumeve të përpunuara nga Byroja e arsimit. Në shkollë plotësisht pranohen të gjithë fëmijët nga rrethina e shkollës.

Në shkollë pranohen edhe fëmijë me nevoja të veçanta në korniza të shkollimit të rregullt, por ekzistojnë vështirësi gjatë ndjekjes së suksesit për shkak të mungesës së ekspertit.

Largimi i nxënësve është si pasojë e shpërnguljes në vende tjera. Përsëritje të klasës nuk ka, ndërsa sukse si mesatar është relativisht i kënaqshëm. Nxënësit në shkollën tone zakonisht notohen në kohë në të gjitha lëndët mësimore. Prindërit dhe nxënësit në kohë informohen për arritjet, notimi bëhet me numra dhe me përshkrim, ndërsa zakonisht gojarisht motivohen se mund të arrijnë sukse më të larta dhe kjo ju ndihmon në atë aspekt.

Shkolla bashkpunon me prindërit përmes bisedës me prindër dhe analizës mjeksore, testeve nga ana e psikologut,mësimdhënësit për edukat fizikedhe shëndetsore,shërbimeve sociale.Psihologu kryen eksaminime të caktuara(sipas nevojës)në mënyrë që të fitoj njohuri për intelektuale,emocionalenevojat fizike

dhe sociale të nxënësve.

Si pjesë e kujdesit,ruajtjes së shëndetit të nxënësve është edhe mënyra e drejtë e të ushqerit,duhet të organizohet ushqim i përbashkëtnë shkollë(në aktivitetet e ardhshme.

Më në fund vijon njoftim për identifikimin e problemeve shëndetsore.

Mbajtja e kushteve higjienike në shkollë

Në rast situate pas konfliktit më së pari bisedohet në orën e kujdestarisë,psiholog,pedagog,drejtor dhe prind.

Në varësisht të informacionit të marrë,të merren masat e duhura:

-Bisedime me ekspert

-Pjesmarja e nxënësve në puntori për zgjedhjen e konflikteve

Shkolla përdor sisteme për punë me nxënës të cilët kan probleme shëndetsore

Sistemi zhvillohet përmes:

-Kontrolle sistematike e nxënësve nga ofruesit e kujdesit shëndetsor

-Zbulim të deformiteteve nga ana e mësimitdhënësit për edukat fizike dhe shëndetsore

-Biseda me prindërit

-Njoftim nga mjeku amë

Në varësi të informacionit të marrë,mësimitdhënësit do të veprojnë në pëputhje me udhëzimet e tyre,përmes ligjeratave për tema të përshtatshme për parandalimin seksual,të mbajtura prej mësimitdhënësit të biologjise dhe psikologut.

## 4.3 Ndhimë këshillëdhënëse për arsimimin e më tutjeshëm të nxënësve

## Niveli gjatë evaulimit – shumë mirë

Shkolla nxënësve iu ofron dhe siguron informacione të qarta, sakta për mundësit e më tutjeshme arsimore, ngritje me profesion ose me punësim. Shkolla nuk ka ndonjë programë konkrete për orjentim profesional të nxënësve për këtë dhe shkollat e mesme organizojnë aktivitete dhe materiale promovuese, të cilat i paraqesin para nxënësve të klasave të nënta (flajere, tribuna, ditë të hapura, vizitë shkollore të mesme, informacione nga mediumet elektronike etj.).

❖ **Ofrimi i ndihmës gjatë zgjedhjes së profesionit-institucionet për arsim të mëtutjeshëm, riarsimim ose punësim.**

Shkolla iu ndihmon nxënësve në zgjedhjen e profesionit respektivisht i informon për rrjetin e shkollave të mesme të R.M.V-së dhe kushtet që nevoiten për regjistrim me të njejtat, ju mundësojmë takime direkte me profesorët të cilët ligjerojnë e të cilët bëjnë prezentimin e shkollave të tyre. Nxënësit përmes kujdestarëve të klasave mësojnë për zgjedhjen e arsimimit të mëtutjeshëm të obligueshëm, tema e njejtë është pikë e rendit të ditës në mbledhjet prindërore sidomos të nxënësve të klasave të VIII-ta dhe IX-ta. Shërbimi profesional rregullisht informon nxënësit dhe profesionalisht i orjenton në zgjedhjen e shkollave dhe drejtimeve në shkollat e mesme përmes flojerave, broshurave në fund bëhet edhe anketimi i nxënësve të klasave të IX-ta. “Ku pas shkollës fillore”.

❖ **Kujdesi për nxënësit me vështirësi emocionale**

Për gjendjen e nxënësve shqetësime ( vështirësi emocionale eventuale të cilat manifestohen përmes zvoglimit të suksesit dhe sjelljes, ardhja e rregullt në mësim probleme me socializimin e ngjashëm, përveç kujdestarit të klasës janë të informuar edhe shërbimi profesional ( pedagog-psikolog, të cilat punojnë në tim për largimin e problemeve eventuale të nxënësve. Me këto nxënës punohet individualisht ose në grup sipas nevojës kyçe dhe prindërit.

❖ **Mbajtja e evidencës për përparimin individual të nxënësve**

Shkolla mbanë evidencë për përparimin e nxënësve në përvetësimin e diturive të reja ( përmes notimit formativ dhe sumativ në kontinuitet, të qenët prezent në mësim, sjelljen e tyre dhe evidentimin e masave të marra pedagogjike.). Përmes punës të këshillit të prindërve takimeve me prindërit dhe në orët e klasës, prindërit dhe nxënësit njohtohen me ekzistimin e shërbimit pedagogjik në shkollë dhe ndihmën që mund ta marrin përmes punës këshillëdhënëse me nxënësit gjatë zgjedhjes së aktiviteteve të lira, mësimi shtues, punën këshillëdhënëse nxënësve që tregojnë sjellje asociale, nxënës jo të rregullt në mësim dhe sukses të dobët në mësim, punë këshillëdhënëse me prindërit fëmijët e të cilëve përparojnë në mësim, ose të cilët kanë probleme me të mësuarit, rregullsinë dhe disiplinën, pjesmarrje në organizimin e aktiviteteve në arsimimin pedagogjik të prindërve përmes ligjeratave profesionale. Shkolla përparimin e nxënësve e ndjek përmes informatave kthyes nga takimet me prindërit dhe arsimtarët përmes pjesmarrjes në gara, tregimi i rezultateve të mira të nxënësve në mësimin shtues ku edhe vjen në shprehje talenti dhe dhuntia e nxënësve ose dhënija ndihmë e nxënësve më të dobët.

-I lajmëron prindërit përmesfletave evidentuese për të arriturat

-Mban evidencë për prezencën dhe mungesat nga orët mësimore në ditarin e paraleles

-Kontaktin me prindërit

-Në mbledhjet prindërore i informon të njejtin për zhvillimin e shkollës gjatë vitit shkollorë

- Përgatitjet e materialit ku është dhënë vizioni për punën e shkollës

-Pjesmarrje në gara në mes shkollave dhe më gjërë

Evidenca për përparimin dhe zhvillimin e nxënësve është në dispozicion të përhershëm si për arsimtarët, prindërit ashtu edhe për nxënësit.

#### 4.4 Ndjekja e përparimit

##### Niveli gjatë evaulimit-shumë mirë

Arsimtarët e ciklit të ulët mbajnë dhe dosie të nxënësit, në të cilat ruhen të gjitha punimet, detyrat dhe tekstet të cilat nxënësi i punon gjatë tërë vitit. Ndjekja e përparimit të nxënësve është e evidentuar në ditarin e paraleles. Prindërit më së paku (4) katër herë gjatë vitit njohtohen për përparimin e nxënësve në mbledhje prindërore ose takime individuale-në ditët e hapura arsimtarët klasor. Përparimi i nxënësve shënohet edhe në listat evidentuese në çdo tre mujor. Në fund të vitit nxënësit marrin dëftesë për suksesin e arritur. Gjatë kalimit të një nxënësi prej një shkolle në tjetrën u jepet fletëshpërngulje me informatë kthyese. Fletëshpërnguljet rruhen te sekretarësh dhe zëvendës drejtoresha, keto ndyshime shënohen në librin amë. Në mungesë të këtyre të dhënave shkolla i drejtohet në formë të shkruar institucionit përkatës si dhe deri te inspektoriatit shtetëror për arsim, po qese bëhet fjalë për nxënës të cilët vin nga ndonjë shtet i huaj për të kërkoher nostrifikim.

##### ❖ Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve

Kujdestarët e klasave në fund të çdo tre mujori dhe gjysmë vjetori japin raport për të arriturat e nxënësve sipas paraleleve. Me këto të dhëna nxënësit rregullisht informohen në orët e klasës, kurse prindërit në mbledhjet prindërore dhe nga ditari elektronik ku të dhënat dërgohen me e-mail adressa të prindërve (kujdestari ose përmes sms). Shërbimi profesional në çdo tre mujor dhe gjysmë vjetor rregullisht përgatit raport për përparimin e nxënësve sipas paraleleve dhe klasave dhe të dhënat e mara nga kujdestarët e klasave në këshillin e arsimtarëve bëhet analiza e të arriturave sipas paraleleve dhe klasave propozohen masa për përmirësimin e të njejtave. Nxënësit të cilët arrijnë rezultate të mira dhe fitojnë shpërblime në gara shtetërore me dhuratë përkatëse shpëblehen nga ana e shkollës. Për nxënësit që tregojnë sjellje jo adekuate u shqyrtohen masa pedagogjike.

Nga raportet shihet se në shkollën tonë nuk kemi problem me rregullsinë, disiplinën dhe sjelljen e nxënësve, kurse sukcesi kënaq. Tek nxënësit te të cilët identifikohen probleme intenzifikohen aktivitetet e shërbimit profesional.

**ANALIZA****Fusha 4 – përkrahja e nxënësve**

Në shkollë ekzistojnë kushte të sigurta për realizimin e mësimitt të rregullt. Shkolla ka të regjistruara masa dhe aktivitete të caktuara për sigurimin e nxënësve gjatë realizimit të mësimitt, si në klasa ashtu edhe në oborrin e shkollës dhe realizohet sipas asaj që janë planifikuar. Infrastruktura në shkollë (mobiljet, shkallët, dyshemet, plafonet, dritaret, vendet për rrymën, oborri etj. Është i sigurtë dhe nuk paraqesin rryk potencial për nxënësit. Nuk ka dukuri të maltretimit psikiko-fizik dhe diskriminimit të çfar do natyre. Në shkollë sanksionohet çdo formë e dhunës që manifestohet nga të rriturit ose nxënësit dhe zbatohen me komision për largimin dhe çrënjosjen e këtzre dukurive. Shkolla ka politikë anti-pirres së duhanit, konsumimit të alkoolit dhe përdorimit të mjeteve narkotike. Kjo nënkupton se në shkollë është e ndaluar të pihet duhan, të vihet në gjendje të dehur. Eksiston bashkpunim me institucionet relevante dhe vetëqeverisje lokale për ndalimin e dukurive devijante në shkollë. Pedagogu dhe psikologu kanë programë ku nxënësve iu jepet ndihmë-këshilla për tejkalimin e dukurive negative. I kushtohet kujdes i duhur ushqimit që konsumojnë nxënësit.

Kujdes i veçantë i kushtohet përkrahjes së nxënësve me pengesa në zhvillim dhe nxënësve me status të ulët socialo-ekonomik. Higjiena është në nivelin e kënaqshëm. Nxënësit janë të mbrojtur në aspekt shëndetësor përmes vaksinimeve të rregullta dhe kontrole sistematike. Kujdes i posçëm u kushtohet nxënësve me probleme shëndetësore. Kemi kujdes për hapsira të pastërta përmes aksioneve të ndryshme ekologjike.

Nxënësve iu jepet ndihmë për arsimimin e mëtutjeshëm nga ana e shkollave të mesme. Orientimi profesional nxënësve dhe prindërve iu tregohet përmes ( fjalorëve, tribunave, ditë të hapura vizita shkollaave të mesme ). Arsimitarët mbajnë evidencë të rregullt për të arriturat e nxënësve, disiplina dhe rregullsinë për çdo nxënës. Eksiston bashkpunimi i mirë midis shërbimit profesional, arsimtarëve, prindërve dhe nxënësve në ndjekjen e përparimit të nxënësve. Mbahen këshillmore me prindërit e atyre nxënësve të cilët janë të dobët në mësim, jo të disiplinuar dhe jo të rregullt në mësim. Rregullisht përgatiten raprte nga ana e arsimtarëve për suksesin e nxënësve (tre mujor, gjysmë vjetorë dhe dëftesat). Të njëjtat rregullisht shqyrtohen nga ana e udhëheqësisë dhe shërbimit profesional kështu që rezultatet nga analizat për përparimin e nxënësve siapas paraleleve.



**REZULTATE****ANËT E FORTA**

- Shkolla është plotësisht e përshtatshme dhe ka hapësirë të adaptuara dhe mjete adekuate për punë me nxënës me pengesa. Kujdesi i përgjithshëm për të gjithë nxënësit pa marrë parasysh pozitën e tyre sociale,materiale,gjinore e etnike ;
- Shkolla ka timin inkluziv,tim për orientim në teknologjinë bashkohore, arsimtarë të trajnuar (përmes seminareve ) për punë dhe përkrahjen e nxënësve me pengesa ;
- Në shkollë ka mekanizma për intervenim me kohë për zgjedhjen e konflikteve dhe formave të ndryshme të dhunës;
- Si shkollë me tri gjuhë mësimore-klima për punë dhe i gjithë procesi edukativo arsimorë zhvillohet në nivel të kënaqshëm.
- Kujdesi për shëndetin e nxënësve ;
- Ndjekja në kontinuitet i përparimit të nxënësve ;
- Eksistojnë masa dhe aktivitete për mbushjen e nevojave:emocionale, fizike dhe psikike të nxënësve ;
- Shkolla bashkëpunon me institucionet e rrethit lokal, personat profesional nga jashtë (qendrën për punë sociale, qendrën medicinale, Kryqin e Kuq, M.P.M etj ).
- Shkolla përmes projekteve të ndryshme mbanë politikë “antipirres së duhanit”konsumimit të alkoolit, distribuimit të narkotikëve.Realizimi i këtyre temave nga programa e shërbimit pedagogjiko-psikologjik të shkollës.
- Në kuadër të shkollës rregullish organizohen aksione punuese-ekologjike.
- Eksiston bashkëpunim me prindërit e nxënësve.
- Bashkëpunimi i rregullt me prindërit përmes rrjeteve sociale.

**ANËT E DOBËTA**

- Nevoja për trajnimet e arsimtarëve për përdorimin e aparateve për zjarrfikje.
- Organizimi i aktiviteteve jashtëmësimore dhe aksione më të shpeshta humanitare.
- Programi konkret për përkrahjen e nxënësve me statut të rrezikuar social.
- Mungesa e mjeteve mësimore nga disa lëndë të caktuara.
- Kodeksi i sjelljes në shkollat periferike.
- Programë për orjentim profesional të nxënësve në shkollim të mëtutjeshëm.
- Nevoja për kujdes më të madh, angazhimi për higjienën në shkollë (përdorja e tualetve nga të pa punësuarit në shkollë).

### Fusha 5. KLIMA E SHKOLLËS

#### Niveli i evaulimit: Shumë mirë

5.1. Klima e shkollës dhe sjelljet në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Reputacioni / Imazhi i shkollës</li> <li>❖ Kodi i sjelljes</li> <li>❖ Klima e shkollës</li> <li>❖ Sjellja dhe disciplina në shkollë</li> <li>❖ Partcipimi i nxënësve në zgjedhjen e problemeve dhe vendimmarjes</li> </ul>
5.2 Promovimi i të arriturave	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Promovimi i aftësive individuale të nxënësve</li> <li>❖ Promovimi i aftësive në emër të shkollës</li> </ul>
5.3 Barazi dhe drejtësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Njohja e të drejtave të fëmijëve</li> <li>❖ Trajtim i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve</li> <li>❖ Pranimi dhe promovimi i multikulturës</li> </ul>
5.4 Marrdhënie partneritet me prindërit, me bashkësinë lokale dhe me bashkësitë e punës	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Bashkëpunimi i shkollës me prindërit</li> <li>❖ Bashkëpunim me bashkësinë lokale</li> <li>❖ Bashkëpunim me bashkësitë e punës dhe organizatat qeveritare</li> </ul>

#### Burimi i të dhënave

- Ditari i paraleles.
- Fletë evidentuese për arritje dhe sjellje.
- Mbikqytja e suksesit nga tremujori.
- Proçesverbalet e këshillëve të mësimit të nxënësve klasor dhe lëndor.
- Anketimi i mësimit të nxënësve, prindërve dhe nxënësve.
- Proçesverbalet nga aktivitetet profesionale.
- Programi vjetor për punë.
- Raport për punën e shkollës.
- Raport nga shërbimi profesional.
- Programi për mësimin shtesë dhe plotësues.

- Të dhënat dhe raportet nga shërbimi pedagogjik-psikologjik.
- Të dhënat nga mësimdhënësit klasor dhe lëndor.
- Të dhënat nga shërbimi administrative (sekretar)dhe libri amzë.
- Programi për punë dhe raporti i punës së shkollës.
- Lista e nxënësve nga vendbanimi.
- Njoftime nga MASH dhe inspektoriati arsimor.
- Intervistë me shërbimin profesional.
- Pasqyrë e të dhënave pedagogjike dhe dokumentacioni.
- Proçesverbali nga këshilli i mësimdhënësve.
- Raport vjetor për punën e shkollës.
- Ligji për arsimin fillor.

## 5.1 Klima dhe marrdhëniet në shkollë

Informatat e mbledhura

### ❖ Reputacioni / Imazhi i shkollës

Në shkollën tonë mbizotëron klimë positive, e bazuar në respektim, tolerancën dhe bashkëpunimin e ndërsjelltë e të gjitha subjekteve në shkollë. Shkolla mund të lëvdohet me kualitet të mirë të punës si dhe me arritjet e nxënësve në fushat e ndryshme gjithashtu me përmbushjen e vizionit dhe misionit të shkollës. Theks të veçantë i është kushtuar shqetësimit për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve. Sidomos në veçanti i është kushtuar kujdes diversitetit gjinor dhe multikulturorë, integritetit ndëretnik në arsim si dhe kujdesi dhe përfshirja në procesin arsimorë të fëmijëve me nevoja të posaçme në jetën shkollore. Në veçanti është e rëndësishme përfshirja e prindërve dhe shoqërisë në jetën shkollore. Numër i madh i mësimdhënësve në shkollën tonë aktivitetin arsimorë e kryejnë me profesionalizëm, ambicje dhe kualitet. Kjo mënyrë e punës kontribon që të arrihen rezultate të larta në aktivitetet arsimore dhe jashtë arsimore me çka rritet reputacioni dhe imazhi i shkollës. Qëllimi jonë është një shkollë me një mjedis të shëndoshë edukativo arsimorë i cili i motivon nxënësit për arritjen e një niveli të lartë të njohurive, aftësive dhe diturive të cilat mundësojnë pregaditje për punë dhe jetë individuale si dhe zbatimin e parimeve dhe principeve të ndershmërisë, tolerancës, përgjegjësisë, respektit të ndërsjelltë, human, respektimit të ngajshmërive dhe dallimeve multikulturore dhe multietnike. Me zbatimin e strategjive dhe teknikave bashkëkohore për arsim i aftësojmë nxënësit për një pjesëmarrje aktive në procesin arsimorë dhe i zhvillojmë aftësitë e tyre.

### ❖ Kodi i sjelljes

Shkolla posedon një kod të sjelljes ku janë të vendosura principet dhe rregullat e sjelljes së nxënësve dhe arsimtarëve si dhe masat pedagogjike të cilat zbatohen në shkollë në rast të sjelljes jodisciplinore dhe mosrespektimi i rregullave të shkollës: vërrejtje, bisedë me shërbimin profesional, bisedë me prindërit, ulje e nivelit të sjelljes, zhvendosje në paralele tjetër dhe zhvendosje në shkollë tjetër.

### ❖ Atmosfera shkollore, sjellje dhe disciplina në shkollë

Shkolla zbaton politikë të respektimit reciprok dhe trajtim të barabartë të të gjitha strukturave që bëjnë pjesë në jetën shkollore. Në shkollë ekziston bashkëpunim profesional ndërmjet të punësuarve. Kuadri udhëheqës dhe arsimorë luajnë rol të rëndësishëm në mbajtjen e atmosferës së mirë në shkollë sikurse shikohet në sjellen e tyre ndaj nxënësve, të punësuarve të tjerë, prindërve dhe vizitorëve të tjerë në shkollë. Sjella tek

nxënësit në përgjithësi është në nivel të kënaqshëm edhe pse ka disa përjashtime. Disciplina gjatë orëve të mësimit është nën kontroll të mësimeve dhe nuk ka probleme të theksuara, kurse disciplina gjatë pushimeve është nën kontroll nga mësuesit kujdestarë. Gjatë orëve dhe mësimeve plotësuere mbizotëron atmosferë pune. Të punësuarit kujdesen për sjelljen e nxënësve dhe sigurinë e tyre gjatë udhëtimit për tek shkolla dhe gjatë largimit nga shkolla, me kujdes dhe autoritet i zgjedhim problemet që i përkasin disiplinës dhe rregullsisë. Sa i përket disiplinës dhe theksimit të masave pedagogjike, edhe pse shkolla sipas rregullores i zbaton, përsëri në një numër të caktuar mungon bashkëpunimi dhe përkrahja nga ana e prindërve që është me rëndësi të veçantë për zgjidhjen e problemeve që janë me interes të përbashkët.

❖ **Participimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe në vendimmarrje.**

Shkolla tenton vazhdimisht që të kyç nxënësit në zgjidhjen e problemeve të caktuara në shkollë. Nxënësit në kohë janë të informuar për çdo gjë që është në interes të tyre dhe nëpërmjet anketave e bisedave me nxënësit gjithmonë mirret parasysh edhe mendimi i tyre për sjelljen e vendimeve që janë me rëndësi për shkollën. Të punësuarit i udhëzojnë nxënësit të kujdesen si për shkollën, gjithastu edhe ndrejt veti. Pothuajse të gjithë nxënësit ( pa marrë parasysh aftësitë, gjininë dhe origjinën ) ndjehen të sigurtë nga të rriturit dhe nxënësit tjerë në shkollë.

## 5.2. Promovimi i të arriturave

Niveli i evaluimit: Shumë mirë

Informatat që janë mbledhur

### ❖ Promovimi i arritjeve individuale të nxënësve dhe arritjet në emër të shkollës

Shkolla në vijim të vitit shkollorë nëpërmjet të metodave të ndryshme gjithmonë i paraqet arritjet e seksioneve dhe nxënësve të cilët kanë arritur rezultate solide. Qysh prej fillimit të vitit shkollorë, shkolla respektivisht kuadri arsimorë i organizon mjedisin për mësim duke i parashtruar pritjet në korelacion me arritjet, rregullën dhe disiplinën e nxënësve. Gjithashtu në programin arsimorë janë paraparë gara diturie, sportive, individuale dhe kolektive, të ngjajshme. Nxënësit janë të motivuar për arritjet nëpër gara lokale, regjionale dhe shtetërore. Ata kanë mundësi që aftësitë dhe kreativitetin e tyre ta shprehin gjatë procesit arsimorë dhe aktiviteteve të lira. Të arriturat e tyre paraqiten para bashkë nxënësve, prindërve dhe opinionit më gjërë. Të arriturat e nxënësve prezentohen nëpërmjet shpalljeve në orët klasore, gjatë manifestimeve shkollore, festën e patronatit, mbledhjet prindërore, gjatë pjesëmarrjes në projektet e organizuara nga shoqëria dhe institucione të ndryshme, gjatë pjesëmarrjes në manifestime të ndryshme nëpërmjet bashkëpunimit me shkollat e tjera dhe në format e ndryshme.

Në këtë mënyrë arrihet që të promovohen të arriturat e nxënësve pa dallim të gjinisë dhe statusit social, me atë arrihet që të afirmohet dhe të vërtetohet ajo që me plan program duhet të ndiqet nëpërmjet realizimit të procesit edukativo- arsimorë në shkollë. Shkolla i përmban dhe i thekson të arriturat e të gjithë nxënësve me përkrahje verbale, me urim dhe motivim individual, me lëvdata dhe shpërblime, me pjesëmarrje në konkurse, gara, shpallje e rezultateve të tyre në shkollë, pjesëmarrje në manifestime të hapura dhe programe kulturore- zbatimëse. Përsëri, për shkak se ka mungesë të mjeteve financiare mungojnë shpërblimet si libra, mjete shkollore etj si motivim plotësues për arritjet më të mëdha të nxënësve. Kuadri arsimorë e shfrytëzon lëvdatën si mënyrë të motivimit, kurse disa arsimtarë llogarisin se ajo nuk është motivim i mjaftueshëm për pjesëmarrje të nxënësve në gara.

### 5.3. Barazi dhe drejtësi

Niveli i evaluimit: Shumë mirë

Informatat e mbledhura

❖ **Njohuritë për të drejtat e fëmijëve, trajtim i drejtë dhe i barabartë i të gjithë nxënësve**

Në shkollën tonë të gjithë nxënësit pa dallim social, gjinorë dhe intelektual trajtohen të barabartë. E njëjtë është edhe sjellja e nxënësve me nevoja të posaçme. Për nxënësit të cilët tregojnë interes të veçantë dhe paraqesin aftësi të caktuara në lëmi të caktuara, në veçanti para pjesëmarrjes në gara, shkolla organizon mësim plotësues, ndërsa për nxënësit të cilët kanë arritur rezultate jo të mjaftueshme shkolla organizon gjithashtu mësim plotësues. Shkolla përpiqet për barazi dhe drejtësi si vlera themelore, në të gjitha dokumentet e shkruara dhe ka zhvilluar mekanizma me të cilat siguron nivelin e respektimit, të marrëdhënieve ndërmjet të gjitha strukturave të cilat marrin pjesë në jetën shkollore ( të punësuarit, nxënësit dhe prindërit). Nxënësit mësohen sesi ti njohin dhe të reagojnë në situata konkrete të diskriminimit në kontekstin shkollore. Të gjithë mësimdhënësit i trajtojnë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nxënësit, pavarësisht nga dallimet e tyre.

Pranimi dhe promovimi i multikulturalizmit

Në shkollën tonë, nxënësit mësohen si të respektojnë kulturën dhe traditën e bashkësive tjera në Republikën e Maqedonisë, pa marrë parasysh se cilit grup etnik i përket. Në shkollë theks të veçantë i vendoset vlerësimit pozitiv diversitetit kulturorë në shkollë dhe bashkësi. Shkolla promovon barazi edhe në përkatësi gjinore të nxënësve në pikëpamje të zhvillimit dhe përparimit të tyre. Shërbimi pedagogo- psikologjik rregullisht e ndjek punën dhe angazhimin e arsimtarëve dhe sjellen e tyre ndaj të gjithë nxënësve

## 5.4. Bashkëpunimi me bashkësinë lokale, bashkësitë e interesit dhe sektorin joqeveritarë

Niveli i evaluimit: Shumë i mirë

### ❖ Bashkëpunimi i shkollës me prindërit

Shkolla është e hapur për bashëpunim me prindërit nëpërmjet:

- ✓ Mbledhjeve prindërore ( Në grup dhe individualisht )
- ✓ Këshillit të prindërve në nivel klasor dhe të shkollës
- ✓ Përfshirje në projekte, në organizimin e ekskurzioneve shkollore
- ✓ Në shënimin e manifestimeve kulturore- zbavitëse

Prindërit në mënyrë aktive janë të përfshirë në punën e shkollës nëpërmjet nivele formale të vendimmarrjes ( këshilli i prindërve, mbledhjet prindërore dhe këshilli shkollorë ) Prindërit e kanë mundësinë që plotësisht të ndjekin dhe përfshihen në punën dhe jetën shkollore dhe ata mundën që të parashirojnë ide, sugjerime dhe mendime. Prindërit kanë mundësi që të ndjekin programe dhe planin vjetorë, informatën për realizimin e projekteve, për zhvillimin, përparimin dhe suksesin e nxënësve. Edhe përkundër përpjekjeve që i bën shkolla për inkuadrimin e prindërve në procesin arsimorë, inkuadrimi i tyre nuk është në nivel të lakmueshëm. Shkolla gjithmonë është e hapur për inkuadrimin me vetë iniciativë për të bashkëpunuar me prindërit gjatë punës dhe jetës në shkollë.

Bashkëpunimi me bashkësinë lokale, bashkësitë e interesit dhe sektorin joqeveritarë

Shkolla ka një bashkëpunim aktiv me bashkësitë lokale në kuadër të kornizave ligjore. Bashkësia gjithashtu bën pjesë në përmirësimin e kushteve të punës në shkollë. Bashkëpunimi me bashkësinë lokale është në nivel të lartë. Me Komunën realizohen kontakte të shpeshta, paraqiten dokumentacione dhe informacione për funksionimin e shkollës. Organet e pushtetit lokal janë të pranishëm me iniciativa dhe vendimarrje në punën e shkollës. Shkolla jonë kontakton dhe bashkëpunon me shkolla të tjera nëpërmjet ekspozitave artistike, garave sportive etj. Shkolla bashkëpunon me bashkësitë e interesit dhe sektorin joqeveritarë/



<b>Metoda tjera për mbledhjen e të dhënave</b>		
<b>Niveli i evalutimit: Shumë i mirë</b>		
Metoda për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja në mbledhjen e të dhënave	Informatat të cilat janë mbledhur
Anketë me nxënësit	Тим на СЕУ	Prej gjithësej 30 nxënësve të anektuar ( 10 djem dhe 20 vajza ) 90% e nxënësve u deklaruan se marrëdhëniet ndërmjet mësuesve dhe nxënësve bazohen në vlerësimin e ndërsjellë, arsimtarët vendosin pritshmëri të qarta në lidhje me rregullsinë dhe disiplinën e tyre dhe të gjithë pajtohen se në shkollë nuk bëhet asnjë ndarje në raport me nxënësit. Të gjithë nxënësit u deklaruan se ekziston vlerësim i ndërsjellë në mes nxënësve nga gjinia e njejtë apo e kundërt. Të gjithë e shkollës tonë ndjehen mirë dhe të sigurt në shkollë. Pjesa më e madhe e tyre pajtohen se disciplina në kohën e mësimit dhe pushimit është e mirë.
Anketë me mësime dhënësit	Тим на СЕУ наставниците	Pas mbarimit të evaluimit integral nuk pati informatë kthyesë për lajmërim të anketës me arsimtarët.
Vëzhgim me nxënësit	Членови на тимот на СЕУ	Në shkollë herë pas here vëren trajtimin e papërshtatshëm ndaj nxënësve me nevoja të veçanta. Shërbimi profesional së bashku me stafin mësime dhënësit bën përpjekje nëpërmjet bisedës me këto nxënës që të eliminohen fenomenet e tilla të shfaqjes.
Bisedë me drejtor, psikolog	Timi i ekipit të vetëvlersimit të shkollës	Shkolla është e hapur për bashkëpunim me prindërit nëpërmjet vizitës së tyre të mbledhjeve prindërore, konkurset e kuizit, manifestimet kulturore sportive, debate ekspertesh, takimet me përfaqësuesit e qendrës lokale si dhe angazhimi dhe pjesëmarrja në më shumë projekte, sidoqoftë interesi i prindërve për të ndjekur punën e shkollës nuk është në nivelin e kërkuar siç është eshte ofrimi i

		mbështetjes materiale. Shkolla nuk ka bashkëpunim reciprok për mbështetje financiare dhe materiale me organizatat e komunitetit lokal. Shkolla është e hapur që të bashkëpunojë edhe me shkollat tjera, trajnimi është në një nivel të pasmë dhe ende po bëhen përpjekje për ta siguruar atë.
Bisedë me drejtor, psikolog	Mësimdhënësit	Nxënësit dhe mësuesit mund të jenë krenar për shkollën e tyre përmes pjesëmarrjes së mundshme në gara, në nivelin e nivelit komunal, republikan dhe çmimeve e fituara në garat me karakter të ndryshëm si dhe pjesëmarrje në garat sportive me rezultate të theksuara.
Bisedë me drejtor, psikolog	Anëtarët e ekipit të vetëvlersimit të shkollës	Nxënësit me nevoja të posaçme të cilët janë në numër të vogël janë përfshirë në mënyrë aktive në veprimtaritë e seksioneve sipas aftësive dhe afiniteteve të tyre. Ata janë mirë të trajtuar nga fëmijët e tjerë, shmangia e dyshimit dhe çka është më e rëndësishme, rritja e miqësisë dhe ndihma ndaj njëri tjetrit. Shkolla ka nevojë për një profesionist ( defektolog dhe logopedist).
Bisedë me prindër,	Anëtarët e ekipit të vetëvlersimit të shkollës	Pothuajse të gjithë prindërit pajtohen se dijnë se kujt mund t'i drejtohen në shkollë për informata të shumë ndryshme dhe se shkolla është e hapur për bashkëpunim me prindërit. Prindërit janë rregullisht të informuar për përparimin e nxënësve dhe ndodhitë në shkollë.

**REZULTATET****Anët e forta**

- Marrëdhëniet midis mësuesve, mësuesit dhe nxënësve bazohen në respekt dhe bashkëpunim të ndërsjelltë pa dallim gjinije i cili konfirmohet përmes aktiviteteve të përbashkëta ( sportive, manifestime kulturore, aktivitete ekkologjike).
- Atmosferë e këndshme për punë
- Sjellja dhe disciplina në shkollë në nivel të lakmueshëm
- Shkolla është e hapur për bashkëpunim me prindërit dhe antarë tjerë të brendshëm të cilët tregojnë gatishmërinë për të kontribuar në përmirësimin e punës dhe jetës shkollore
- Ekziston një interes i mirë tek nxënësit për gara me karakter të ndryshëm
- Shkolla i ndjek arritjet e nxënësve në mënyrë të barabartë, thekson përpjekjet e tyre dhe u jep atyre mbështetje fizike
- Shkolla përgjithësisht dhe në kohë i informon prindërit për arritjet e nxënësve dhe për ndodhitë e tyre në shkollë dhe i angazhon ato në punët e shkollës

**Anët e dobta**

- Interesimi i prindërve për të ndjekur punën e shkollës nuk është në nivelin e kërkuar, si dhe sigurimi i mbështetjes financiare.
- Shkolla nuk ka bashkëpunim reciprok për mbështetje financiare dhe materiale me organizatat vendore në mjedisin lokal.
- Mungesa e shpërblimeve për nxënësit dhe mësuesit e talentuar
- Mungesa e raportimit nga ana e inspektoriateve për punën e mësuesve

**Analiza e rezultateve**

Një nga detyrat me prioritet të shkollës në arritjen e punës së deritanishme të shkollës ishte zhvillimi bashkëpunimit, tolerancës, përgjegjësisë dhe përmirësimi i kushteve të brendshme të punës.

- ✓ Stafi mësimorë ka një marrëdhënie respektuese me prindërit dhe nxënësit
- ✓ Shkolla në përputhje me rrethanat zbaton rregulloren për shqiptin e masave pedagogjike dhe rendin në shkollë
- ✓ Stafi mësimorë përcakton pritshmëri të qarta në lidhje me arritjet, rregullësinë dhe disiplinën e nxënësve
- ✓ Shkolla i aftëson nxënësit të shprehin potencialin e tyre krijues në mësimdhënie dhe aktivitete jashta shkollore

- ✓ Në shkollë udhëhiqet një interesim për të drejtat e fëmijëve përmes përmbajtjes edukative që nxënësit përgadisin për jetën në shoqëri.
- ✓ Shkolla ndërmerr aktivitete për përfshirjen e prindërve në punën edukative të shkollës në të gjitha nivelet.
- ✓ Shkolla organizon takime individuale me prindërit dhe takime grupore.
- ✓ Informatat në lidhje me punën e shkollës janë të qarta dhe të arritshme për prindërit.
- ✓ Prindërit ndjehen të mirëseardhur në shkollë.
- ✓ Shkolla është e përfshirë në mënyrë aktive në jetën e komunitetit lokal.
- ✓ Në shkollën tonë mbizotëron klimë pozitive me trajtim të barabartë për të gjithë nxënësit pa dallime sociale, gjinore dhe intelektuale.
- ✓ Bashkëpunimi me prindërit nuk është në nivel të kënaqshëm
- ✓ Shkolla si institucion është e hapur për bashkëpunim me institucionet tjera arsimore, me pronat lokale të cilat shfaqin interes për bashkëpunim
- ✓ Marrëdhëniet midis nxënësve dhe marrëdhënia nxënës- mësues bazohet në ndershmëri, respekt të ndërsjellë dhe bashkëpunim
- ✓ Arritjet dhe rezultatet e nxënësve ndiqen vazhdimisht dhe promovohen në mënyra të ndryshme.
- ✓ Shkolla nuk ka probleme më të mëdha në marrëdhënie me disiplinën dhe sjelljen e nxënësve dhe në qoftëse shfaqen devijime të tilla tek nxënësit reagohe në kohë nga arsimtarët dhe punëtorët profesional përmes punës aktuale ditore me nxënësin dhe prindërin e tij për tejkalimin e problemit.
- ✓ Me regjistrimin e fëmijut në shkollë prindërit njoftohen me kushtet e punës në shkollë dhe u jipen udhëzime për përgaditjen e fëmijut në shkollë.

### Aktivitetet e ardhshme

1. Bashkëpunim më i madh me prindërit si dhe mbështetje e tyre në krijimin e kushteve më të mira për mësimdhënie bashkëkohore.
2. Bashkëpunim më i madh me shkollat tjera
3. Përfshirja e organizatave joqeveritare në mbështetje financiare dhe materiale të shkollës
4. Trajnim i vazhdueshëm i mësuesve për punën dhe përcjelljen e nxënësve me ngatëresa në zhvillimin mendorë dhe fizik.
5. Krijimin e një sistemi për të shpërblyer nxënësit e talentuar
6. Kirjimin e një sistemi për shpërblimin dhe motivimin e mësuesve.

<b>6. RESURSET</b>	
<b>Niveli i vlerësimit: Shumë mirë</b>	
Indikatorët e cilësisë	
<b>6.1</b> Vendosija dhe kapacitet hapësinore	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Kushtet hapësinore</li> <li>❖ Shfrytëzimi i cilësive hapësinore</li> </ul>
<b>6.2</b> Mjetet dhe materialet mësimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Furnizimi me literaturë profesionale dhe mjete mësimore si dhe pajisjeve</li> <li>❖ Biblioteka shkollore</li> <li>❖ Materiali i shfrytëzuar</li> </ul>
<b>6.3</b> Sigurimi i kuadrit të nevojshëm shkollor	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Numri i të punësuarve adekuat i kuadrit arsimorë</li> <li>❖ Efikasiteti dhe shpërndarja e kuadrit</li> <li>❖ Shërbimi profesional si përkrahje e kuadrit arsimorë</li> </ul>
<b>6.4</b> Përcjellja e nevojave zhvillimore të kuadrit arsimorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Zhvillimi profesional i mësimdhënësve</li> </ul>
<b>6.5</b> Puna me financa në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Veprimet me të cilat sigurohet respektimi i rregullativës ligjore për punën me financa</li> <li>❖ Transparenca në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit të shkollës</li> </ul>
<b>6.6</b> Ushqimi i shëndetshëm i nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Sigurimi i kushteve për ushqim të shëndetshëm të nxënësve</li> </ul>

**Burimet e të dhënave**

- Programa vjetore për punën e shkollës
- Bisedë me arsimtarët,shërbimi profesional dhe plan për zhvillimin e shkollës
- Vëzhgim jo i drejtpërdrejtë
- Procesverbale nga inspektorë të arsimit dhe sanitarë
- Bisedë me bibliotekist
- Bisedë me nxënës
- Të dhënat kryesore për aktivitetet
- Bisedë me arsimtarët
- Raport gjysmëvjetorë dhe vjetorë
- Bisedë me personelin
- Procesverbale për punën e aktiveve profesionale
- Skica
- Vëzhgim jo i drejtpërdrejtë, në dokumentacionet e shkollës për furnizim të literaturës profesionale dhe mjete ndihmëse mësimore
- Bisedë me arsimtarët, shërbimin profesional, bibliotekistin, nxënësit dhe personelin teknik

- Plan për zhvillimin e shkollës
- Vëzhgim për evidencën e bibliotekës
- Plan financiarë mujorë për nevojat e shkollës
- Vëzhgim në dosjet e të punësuarve
- Vëzhgim në rregulloren për sistematizim
- Biseda me drejtorin dhe mësimdhënësit
- Programa për punë e shërbimit profesional
- Akte interne
- Lista për trajnimet e kryra

6.1 Vendosja dhe kapacitet hapësinore Niveli i vlerësimit: Shumë mirë	
Burimet e të dhënave	Informatat e grumbulluara
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programi vjetor për punën në shkollë</li> <li>• Biseda me mësimdhënësit, shërbimin profesional dhe plani zhvillimor i shkollës</li> <li>• Këqyrje e drejtpërdrejtë</li> <li>• Procesverbale nga inspeksioni për arsim dhe sanitari</li> <li>• Bisedë me bibliotekistin</li> <li>• Bisedë me nxënësit</li> <li>• Të dhëna bazë për veprimtarinë</li> <li>• Bisedë me mësimdhënësit</li> <li>• Raporti gjysmë vjetor dhe vjetor</li> <li>• Bisedë me personelin</li> <li>• Procesverbalet nga puna me aktivin profesional</li> <li>• Skicë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtet hapësinore</li> </ul> <p>Veprimtaria edukativo - arsimore në shkollë realizohet në një godinë shkollore në shkollën qendrore dhe në një godinë shkollore në shkollat periferike në f. Turçan, në f. Llakavicë dhe lagjen Cigllanë. Kushtet hapësinore në shkollat periferike korrespondojnë me numrin e nxënësve nëpër paralele. SHFQ ndodhet në qendër të qytetit në Gostivar.</p> <p>Për shkak të mospasjes së kushteve hapësinore shkolla do të sigurojë kushte adekuate konform përmbushjes së këtij qëllimi.</p> <p>Shkolla disponon një sallë për edukatë fizike, kabinet për informatikë, kimi dhe biologji, në disa pjesë në shkollë janë montuar kompjuterë dhe mësonjëtoje me pajisje adekuate për realizim të mësimdhënies. Në shkollë funksionon dhe biblioteka shkollore. Nyjet sanitare janë në gjendje të mirë, higjiena është në rregull dhe i kushtohet kujdes më të madh.</p> <p>Shkolla ka nevojë për hapësira shtesë dhe kabinate për realizim të pandërprerë të procesit arsimorë. Mësimi realizohet në dy turne dhe tri mes turne në SHFQ, kurse në SHFP në një ndërrim.</p> <p>Për fëmijëri të shëndetshme të nxënësve, shkolla përpiqet për ushqim të shëndetshëm të nxënësve me moton “ Ushqim i shëndetshëm për fëmijëri pa mangësi”.</p>
6.2 Mjetet dhe materialet mësimore Niveli i vlerësimit: Shumë mirë	



Burimet e të dhënave	Informatat e grumbulluara
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Këqyrje e drejtpërdrejtë në dokumentacionin e shkollë për furnizim me literaturë shkollore dhe mjete mësimore,</li> <li>• Bisedë me mësime dhënësit, shërbimin profesional, bibliotekistin, nxënësit, personelin teknik</li> <li>• Plani zhvillimor i shkollës</li> <li>• Këqyrje në evidencën e bibliotekës</li> <li>• Raporti gjysmë vjetor dhe vjetor</li> <li>• Procesverbalet nga puna me aktivin profesional</li> <li>• Këqyrje në dokumentacionin për planifikim të furnizimit me materiale harxhuese</li> <li>• Plani mujor financiar për nevojat e shkollës</li> <li>• Raporti gjysmë vjetor dhe vjetor, programi për punën në shkollë</li> </ul>	<p>❖ Pajisja me literaturë profesionale dhe mjete mësimore dhe pajisje</p> <p>Shkolla pjesërisht disponon me literaturë profesionale për mësime dhënësit që korrespondon me kurset bashkëkohore mësimore. Shkolla ka literaturë profesionale doracak të dorëzuar nga MASH, revista profesionale (fjalë-kryqe edukative) që në masë të mjaftueshme i përmbushin nevojat e mësime dhënësit.</p> <p>Disponojmë dhe me sasi të mjaftueshme të mjeteve mësimore që i përmbushin nevojat dhe për atë qëllim shkolla harton plan për nevojat me mjete dhe pajisje mësimore dhe ndërmer hapa në vazhdimësi që t'i furnizojë kurse ata permanente që t'i ripërtërijë. Me lëshimin në përdorim të kompjuterëve të mësuarit dhe mësimit u standardizuan me akoma një burim të diturisë si për mësime dhënësit dhe për nxënësit me qasjen në internet, tabela smart, letra, mjete financiare, salla për edukim shëndetësor dhe fizik.</p> <p>Shkolla disponon me bibliotekë me një numër të mjaftueshëm të botimeve me lektura kurse si rrjedhojë nevojat e nxënësit janë në rritje. Shkolla në mënyrë permanente orvatet për rritjen e volumit të këtij fondi. Shkolla planifikon dhe në kohë siguron materiale për shfrytëzim në sasi për realizimin pa pengesë të aktiviteteve shkollore dhe jashtë shkollore konform planit dhe programit shkollorë.</p>

**6.3 Sigurimi i kuadrit të nevojshëm shkollor****Niveli i vlerësimit: Shumë mirë**

Burimet e të dhënave	Informatat e grumbulluara
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Këqyrje në dosjet e të punësuarve</li> <li>• Këqyrje në rregulloren për sistematizim</li> <li>• Bisedë me drejtorin dhe mësimitdhënësit</li> <li>• Programi vjetor për punën në shkollë</li> <li>• Programi për punën me shërbimin profesional</li> </ul>	<p>❖ Numri i të punësuarve adekuat të kuadrit arsimorë</p> <p>Shkolla ka siguruar kuadër profesional për realizim të pandërprerë të procesit edukativo-arsimorë. Mësimitdhënësit rregullisht i kryejnë detyrimet e punës sipas rregullave, respektojnë orarin e punës kurse shkolla përcjell mësimitdhënien e tyre në punë. Profesionalizmi i kuadrit arsimorë është në përputhje me normativin e punës. Mësimitdhënësit me përvojë më të gjatë u ndihmojnë kolegëve të tyre më të rinj për realizimin me sukses të procesit edukativo-arsimorë.</p> <p>Efikasiteti dhe përcaktimi i kuadrit. Ekziston bashkëpunimi mes kuadrit arsimorë dhe personelit administrativ-teknik në shkollë. Kuadri arsimorë posedon një morri kualifikimesh, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Edukimi qytetar,</li> <li>- Multi-etnicitet,</li> <li>- Inkluzion</li> </ul> <p>Kuadri arsimorë po ashtu posedon një morri kualifikimesh, shkathtësi dhe eksperiencë të përfituara përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme për çdo lëndë mësimore. Kuadri arsimorë është në përputhje me normativet e parapara me ligj për arsimin fillorë, të bartura në rregulloren për sistematizim në shkollë të gjithë të punësuarit në mënyrë të ndërgjegjshme dhe solide t'i ushtrojnë detyrat e tyre në punë me sukses si ekip në suaza të aktivitetit profesional. Në rast të munguarit në një kohë më të gjatë ose më të shkurtë të mësimitdhënësve shkolla bën ndërrim të shpejtë dhe adekuat për mësimitdhënësin që mungon. Organizohen dhe orë mësimore për certifikatë si përkrahje e kuadrit arsimorë. Në shkollë ka psikolog dhe pedagog që përmes lëmive programore individuale me programet e tyre vjetore kanë aktivitete të planifikuara për punën me nxënës, prindër dhe mësimitdhënësit dhe çdoherë janë të gatshëm për ndihmë dhe bashkëpunim transparent.</p>

**6.4 Përcjellja e nevojave zhvillimore të kuadrit arsimorë****Niveli i vlerësimit: Shumë mirë**

Burimet e të dhënave	Informatat e grumbulluara
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Akte interne</li>   <li>• Bisedë me shërbimin profesional, mësimit dhe drejtorin</li>   <li>• Lista e trajnimeve interne të realizuara</li> </ul>	<p>❖ Zhvilli profesional i mësimit</p> <p>Zhvilli profesional i mësimit</p> <p>Mësimit kanë nevojë për aftësi profesionale për përmirësimin e aftësive profesionale. Shkolla identifikon nevojat e mësimit për zhvillim profesional dhe ka strategji për diseminim të njohurive të kuadrit. Shkolla do të orvatet që mësimit të ballafaqohen me ngritjen e vetëdijes tek nxënësit qysh nga mosha për të ushqyerit e shëndetshëm për të cilën nevojiten grante të vogla dhe të mëdha. Shkolla respekton rregullativë ligjore për zhvillim profesional të kuadrit. Mësimit fitojnë mundësi për pjesëmarrje në seminare të organizuara nga BZHA, MASH, projekte për modernizimin e arsimit, si dhe projekte që realizohen nga ana e OJQ-ve dhe institucioneve tjera. Vlerësimi i punës së mësimit si dhe identifikimi i nevojave të tyre kryhet përmes vizitës në orë mësimore nga ana e drejtorit dhe nga ana e shërbimit profesional dhe përmes punës së aktivitetit profesional. Punën e mësimit-praktikantë e përcjell mentori që caktohet nga këshilli i mësimit të shkollës për dhënien e ndihmës adekuate praktikantëve. Mentori punon sipas programit të hartuar paraprak, kurse pas përfundimit të përvojës praktike ose angazhimit të punësuarit mentori jep raport dhe mendim për punën me praktikantë. Procedura në tërësi vëzhgohet. Punën e mësimit praktikantë e përcjell psikologu i shkollës i cili gjatë përvojës praktike jep ndihmë profesionale. Aftësimi profesional dhe metodik-didaktik përfshinë aktivitetet për njohjen e mësimit dhe kuadrit tjetër profesional në shkollë me ndryshimet dhe risitë dhe të arriturat në shkencë dhe teknologji të procesit arsimorë dhe trajnimit të tyre për realizimin e mësimit sipas detyrës dhe nevojave bashkëkohore. Temat për trajnime të kuadrit arsimorë zgjidhen sipas nevojave dhe interesit të mësimit kështu që të gjithë përfshihen dhe zgjidhen me propozime të dorëzuara. Në nivel të shkollës organizohen trajnime në të cilat kryhet diseminimi i njohurive të kuadrit. Në shkollë mësimit posedojnë portofolet e tyre dhe dosjet e mësimit përmes të cilave përcillet zhvillimi profesional i mësimit.</p>

## Rezultatet

### Anët e forta

